



NËNA E PARË TËRHEQ PARAPAGESËN PREJ 5000 ALL

Përgjatë vitit të dytë të iniciativës “Çdo fëmijë rom në kopsht”, një ndër 50 fëmijët e komunitetit rom të regjistruar në kopshtet dhe grupet parashkollore të Tiranës, ka qenë edhe vogëlushja 3 vjeçare A.

A. jeton së bashku me nënën (20 vjeç), babain (20 vjeç) dhe motrën e saj më të vogël (1 vjeç e 6 muaj) në barakën e tezes së babait, sepse prindërit e këtij të fundit kanë ndërruar jetë para shumë vitesh.

Një element tepër i rëndësishëm që vlen të theksohet për këtë familje të re është fakti se kemi të bëjmë me ‘një nënë kryefamiljare’, për shkak se bashkëshortët në fjalë nuk kanë bërë ende celebrimin. Prindërit e A. përpara se vajza e tyre të regjistrohej në kopsht ishin të dy të papunë, por falë kopshtit tashmë nëna (7 muajshe shtatzanë) ka gjetur kohën e nevojshme për të filluar një punë në treg, ndërsa bashkëshorti vijon të jetë i papunë.

Përveç fitimeve të siguruara nga babai i vogëlushes të cilat nuk mjaftojnë për të përmbushur nevojat bazë të të gjithë pjestarëve, familja nuk ka asnjë burim tjetër të ardhurash qoftë kjo prej trajtimit me ndihmë ekonomike apo asistencë sociale.

Si rrjedhojë e sa më sipër, vogëlushja 3 vjeçare në momentin e regjistrimit në kopshtin 38 e përfitoi atë falas, sepse i përkiste një prej kategorive të fëmijëve të listuara, në urdhërin e Këshillit Bashkiak Tiranë për rimbursim të kopshtit, por nuk mundi t’i shpëtonte parapagesës prej 5000 ALL. Përkundrejt kësaj pagese, dëshira e prindërve të A. për ta dërguar atë në kopsht i detyroi të ‘futen’ në borxh tek të afërmit, vetëm e vetëm që A. të merrte edukimin e duhur si të gjithë fëmijët e tjerë.

NËNA E PARË E CILA U SHOQËRUA PREJ STAFIT TË CRCA-së TEK QENDRA EKONOMIKE PËR TË TËRHEQUR TARIFËN E PAGUAR DHE TË PANEVOJSHME ISHTE PIKËRISHT NËNA E VOGËLUSHES A.

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni: info@crca.al ose në numrin: +355 4 2265741

THE FIRST MOTHER WITHDRAWS THE GUARANTEE OF 5000 ALL

During the second year of the initiative "Every Roma Child in Kindergarten", one of the 50 Roma children enrolled in kindergartens and pre-school groups in Tirana, has also been the 3-year-old girl A.

A. lives with her mother (20 years old), father (20 years old) and her little sister (1 year and 6 months) in their families “Baraka”, because her father’s parents have passed away many years ago.

A very important element worth mentioning about this new family is the fact that the head of the family is the mother, because the spouses have not yet married. The little girl’s parents, before enrolling her in the kindergarten were both unemployed, but now thanks to her enrollment in the kindergarten, the mother (7 months pregnant) found the time to start a job in the market, while the husband continues to be unemployed.

Besides the earnings provided by the father of the little girl, which are not enough to fulfill the basic needs of all members, the family has no other source of income neither from the economic aid or social assistance.

As a result of the above, the 3-year-old little girl at the time of enrollment in kindergarten no. 38 in Tirana, though belonged to the category of families that should have profited of the service for free according to the Municipal Councils Order for kindergarten refund, yet had to pay the guarantee of 5000 ALL. Despite the payment, the desire of A’s parents to send her to the kindergarten forced them to ‘enter’ into debt with their relatives so A. could receive proper education as all other children.

THE FIRST MOTHER, WHICH WAS ACCOMPANIED FROM CRCA STAFF TO THE ECONOMIC CENTER OF THE MUNICIPALITY TO WITHDRAW THE UNNECESSARY GUARANTEE FEE, WAS THE MOTHER OF THE LITTLE GIRL A.

For more information please contact: info@crca.al or +355 4 2265741.